

MODEL I NJË KËRKESE ANKIMORE

Durrës, më ____ / ____ / ____

KËRKESE ANKIMORE

- ANKUES:** **Paditësi Emri, Mbiemri,** atësia, datëlindja, vendlindja, adresa e saktë e njoftimit sipas vendbanimit/vendqëndrimit, përfaqësuar në gjykim nga avokati ____ sipas prokurës së posaçme/përgjithshme me referencat përkatëse.
- KUNDËR:** **Vendimit gjyqësor nr. ____ , datë ____** të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë
- OBJEKTI:** Ndryshimi i vendimit gjyqësor për masën e shpërblimit të dëmit nga x mijë lekë në y mijë lekë, bazuar në nenet 44 e vijues të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar
- PALËT E TJERA:** **I paditur organi publik _____,** adresa e saktë e tij sipas selisë së regjistruar. *(Shembull: Inspektorati Shtetëror i Arsimit, me adresë në Tiranë, Rruga e Durrësit, nr.219)*

GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARE DURRËS

I nderuar z. kryetar,
Të nderuar z. gjyqtarë,

Hyrje

Një hyrje e shkurtër me të cilën tregohet në mënyrë të përmblodhur se çfarë është vendosur me vendimin gjyqësor që ankimohet.

Në pjesën shpjeguese të ankimit jepet parashtrimi i qartë i kërkesave kundër vendimit gjyqësor, duke bërë një ndarje të tyre në (1) kërkesa për procedurën e zbatuar në gjykimin në shkallë të parë dhe arsyet pse shkelja e pretenduar ka ndikuar në dhënien e vendimit dhe (2) kërkesa për themelin e vendimit, të cilat nënkategorizohen në kërkesa për zbatimin e ligjit material dhe në kërkesa mbi saktësinë e fakteve të pranuar nga gjykimi në shkallë të parë. Në parashtrimin e kërkesave sugjerohet që ato të listohen të numëtuara, duke ndjekur rendin kronologjik. Në parashtrimin e pretendimeve, nëse ato lidhen me çështje fakti, tregohen edhe provat mbështetëse të tyre, duke analizuar fuqinë provuese të tyre. Nëse pretendimet lidhen me çështje ligjore, sugjerohet që ato të shoqërohen edhe me pjesë përkatëse të jurisprudencës së gjykatave më të larta.

Nëse është rasti, tregohen provat e reja që duhet të merren nga Gjykata e Apelit dhe shkaqet e sakta, për të cilat këto prova nuk janë kërkuar apo nuk janë marrë në gjykimin në shkallë të parë (dokumente, dëshmi, ekspertim, CD etj.)

Në pjesën përmbyllëse të ankimit parashtrohen saktë kërkimet, për të cilat kërkohet të shprehet Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës (në përputhje me objektin e ankimit)

Me respekt,

ANKUES

Paditësi Emër, Mbiemër, nënshkrimi

I. Aktet e ankimit

1.1 Ankimi i zakonshëm

Fillimisht, në lidhje me ankimin ka rëndësi analiza krahasuese midis LGJA dhe K.Pr.Civile, e cila, në fakt, ka një shtrirje në pothuajse të gjitha institutet e gjykitit administrativ. Kjo veçori buron nga fakti se teknika legislative e përzgjedhur për hartimin e LGJA përcaktoi K.Pr.Civile si tekst ligjor plotësues dhe specifikues. Një zgjedhje e tillë u maturua duke marrë parasysh disa tregues. Së pari, ishte nevoja për të ruajtur traditën procedurale, sipas së cilës gjykimi administrativ ishte pjesë e K.Pr.Civile të miratuar në vitin 1995 dhe ndonëse ai përcaktohej si gjykim i posaçëm, ndryshimet e tij nga gjykimi i zakonshëm civil ishin të pakta. Për këtë shkak, doktrina dhe jurisprudenca e kohës kishte krijuar njëfarë lidhjeje organike midis këtyre dy gjykimeve. Zgjedhja e një teknike, sipas së cilës të përpilohej një ligj apo kod tërësisht i ri, pa asnjë referencë tek K.Pr.Civile, përveçse do të rezultonte në një sipërmarrje të vështirë, do të passillte edhe një lloj humbjeje të kujtesës jurisprudenciale dhe doktrinale, për ato pjesë që zbatoheshin me efekte pozitive. Kjo është arsyeja që një rregull i tillë është i parashikuar që në nenin 1, paragrafi 2 të LGJA, teksa janë saktësuar kufijtë ndarës, si dhe marrëdhënia ndërvepruese midis këtyre dy ligjeve bazë. LGJA përshkohet nga rregulli, sipas të cilit për çdo institut të gjykitit administrativ baza rregullatore gjendet dhe është e vlefshme në K.Pr.Civile, nëse vetë LGJA nuk parashikon ndryshe, që tregon edhe përparësinë e LGJA midis dy ligjeve në fjalë. Rregulli i mësipërm është i përsëritur në disa nga dispozitat e LGJA, shenjë kjo e rëndësisë që i ka kushtuar legjislatori këtij rregulli. Për më tej, në nenin 44 të LGJA, teksa trajtohen në vija të përgjithshme ankimet, pohohet se për mjetet dhe afatet e ankimeve rregullat bazë do të jenë ato të parashikuara në K.Pr.Civile, përveç rasteve kur vetë LGJA përmban rregulla që parashikojnë një trajtim të ndryshëm. Në këtë kuptim, analiza krahasimore midis LGJA dhe K.Pr.Civile bëhet jo vetëm për mjetet dhe afatet e ankimeve, por edhe për të gjitha elementet e tjera të konceptit procedural të ankimit.

1.2 Koncepti i ankimit

LGJA përgjatë gjithë tekstit të tij përdor termin “ankim”. Duhet të saktësohet se termi “ankim” i referohet të drejtës subjektive (me natyrë procedurale), që gëzojnë subjektet e gjykitit administrativ (palët). Pra, në këtë kuptim bëhet fjalë për një të drejtë me natyrë materiale. Kykoncept është i ndryshëm nga ai i “kërkesës ankimore”, që i referohet dokumentit me të gjitha ekstremitetet formale ligjore. Në punën e përditshme ndodh rëndom që praktikantët e së drejtës, kërkesës ankimore i referohen me termin ankim. Për qëllime të këtij Manuali është e rëndësishme të bëhet një dallim i tillë, jo vetëm për saktësi profesionale, por edhe për të lehtësuar kuptimin e shkëlqeve të mundshme dhe pasojave që vijnë prej këtyre shkëlqeve. Doktrina e përkufizon ankimin brenda rrjedhës së procesit gjyqësor, ku ky i fundit konceptohet si një zinxhir i njëpasnjëshëm veprimesh procedurale, herë me impuls të palëve dhe herë me impuls të vetë gjykatës, të cilat ndërlidhen dhe nënrenditen me njëra-tjetrën sipas një mekanizmi logjik shkak-pasojë. Procesi gjyqësor merr shkas nga ushtrimi i të drejtës së padisë (e materializuar në aktin procedural të kërkesëpadisë) dhe përfundon me aktin më të fundit të procesit, që është shpallja e vendimit përfundimtar të gjykatës. Ankimi, i konceptuar si e drejtë subjektive me natyrë procedurale është një e drejtë që më së shumti shpreh vullnetin subjektiv të palëve në gjykim për ta transferuar fazën e gjykitit nga shkallë të parë në shkallën e dytë.

Këtu duhet saktësuar se “ankimi” sipas nenit 44 të LGJA i referohet pikërisht aktit që përcjell procesin gjyqësor nga shkalla e parë e gjykimit në atë të shkallës së dytë (apel). Ky lloj ankimi është i ndryshëm nga akti që bën kalimin nga gjykimi në shkallë të dytë në gjykimin në Gjykatën e Lartë me anë të rekursit. Kur ankimi konceptohet si e drejtë subjektive, ai nuk është gjë tjetër veçse një akt vullneti i brendshëm, titullar i të cilit janë vetëm subjektet e gjykimit. Ligji një të drejtë të tillë ua njeh vetëm palëve në gjykim. Në këtë pikëpamje, vlefshmëria e vullnetit të ushtrimit të të drejtës së ankimit duhet të analizohet sipas rregullave për vlefshmërinë e veprimeve juridike, që trajtohen në K.Civil. Trajtimi i elementeve formale, që duhet të respektojë ushtrimi i kësaj të drejte, i takon më pas regjimit juridik të kërkesës ankimore, që nuk është gjë tjetër veçse shfaqja e jashtme e vullnetit për të ushtruar ankimin.

1.3 Efektet e ankimit

Një nga instrumentet më të mira për të përkufizuar në mënyrë të plotë ankimin është identifikimi i efekteve juridike të tij. Ankimi, si e drejtë procedurale është një nga aktet më të rëndësishme shtytëse në dorë të palëve ndërgjyqëse për ta transferuar procesin gjyqësor nga një fazë tek tjetra, madje edhe nga njëra shkallë në tjetrën, ku këto shkallë gjykimi kanë dallime cilësore midis tyre. Në këtë pikëpamje ai paraqet ngjashmëri me të drejtën e padisë. Nuk është aspak e rastit, që e drejta e ankimit gjen trajtim në nivel kushtetues, madje edhe në KEDNJ. Ky arsytim është i vlefshëm jo vetëm për ankimin i zakonshëm, por edhe për ankimin e veçantë. Në kushtet kur ushtrimi i të drejtës së ankimit vendos kufirin midis dy shkallëve të procesit gjyqësor, efektet e tij duhet të analizohen në dy drejtime: (1) efektet ndaj procesit gjyqësor në shkallë të parë dhe (2) efektet ndaj procesit gjyqësor në shkallë të dytë. Lidhur me efektet ndaj procesit gjyqësor në shkallë të parë duhet theksuar se në nenin 45 të LGJA flitet për ndalimin e ankimit ndaj disa vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative të shkallës së parë. Ajo që duhet të mbahet parasysh në zbatimin korrekt të kësaj dispozite është saktësimi i pagës minimale në shkallë vendi, vlera e së cilës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe për këtë shkak është periodikisht e ndryshueshme. Pavarësisht kësaj vështirësie, ky sistem reference për vlerën e çështjes që ankimohet është menduar t'i shërbejë rezistencës në kohë të ligjit, duke shmangur ndryshimet e vazhdueshme të tij për shkak të zhvlerësimit në kohë të monedhës.

Në praktikë, ka një diskutim mbi përputhshmërinë e nenit 45 të LGJA me nenin 43 të Kushtetutës, kur vetë Kushtetuta nuk parashikon në mënyrë taksative përjashtime nga e drejta e ankimit. Megjithatë, përgjatë diskutimeve parlamentare të LGJA është përdorur si kontekst kushtetues që justifikon këtë ndalim ligjor të ankimit, neni 17 i Kushtetutës, sipas të cilit, kufizimet e të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj dhe për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, me kushtin që kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar atë. Përsa i përket efekteve ndaj procesit në shkallë të parë është e rëndësishme të dallohet se ankimi i ushtruar nga një palë, në përfundim të procesit në shkallë të parë, i referohet procesit gjyqësor në tërësi të zhvilluar në shkallë të parë dhe jo thjesht vendimit të dhënë në përfundim të këtij procesi. Konkretisht, një palë gjyqësore ushtron të drejtën e ankimit pasi është e pakënaqur me zgjidhjen e dhënë nga vendimi përfundimtar. Po ashtu, është e vërtetë se kërkesa ankimore plotësohet si mjet kundërshtues ndaj vendimit të shkallës së parë, por mund të ndodhë që ankimi të godasë veprime procedurale të gjykimit, të cilat mund të mos pasqyrohen fare në vendimin përfundimtar, por kanë diktuar në mënyrë thelbësore dhënien e këtij vendimi. Të tilla mund të jenë një procedurë

për kryerje ekspertimi, një procedurë për përjashtim gjyqtari apo një procedurë për marrjen e një prove. Rregulli, sipas të cilit për disa vendime të ndërmjetme mund të bëhet ankimi i veçantë në mënyrë të menjëhershme, nuk duhet të krijojë idenë se për rastet e tjera, vendimet e ndërmjetme nuk ankimohen dhe që ankimi ndaj vendimit përfundimtar nuk përfshin çështje të procedurës së ndjekur për marrjen e vendimit. Me këtë analizë arrihet në përfundimin se ankimi është mjeti, i cili bën të mundur një kontroll të procedurës gjyqësore të realizuar nga gjykata e shkallës së parë nën optikën se sa kjo procedurë ka ndikuar në vendimin e dhënë. Një efekt tjetër më i veçantë dhe më i dukshëm i ushtrimit të ankimit ndaj procesit gjyqësor në shkallë të parë lidhet me faktin se ushtrimi i ankimit në mënyrë të vlefshme (brenda afatit dhe në respekt të plotë të kërkesave formale të kërkesës ankimore) pengon që vendimi i gjykatës së shkallës së parë të marrë formë të prerë.

Ankimi jep efekte edhe ndaj procesit gjyqësor të ardhshëm, gjykimit në apel. Ushtrimi i ankimit i hap rrugën procesit gjyqësor të zhvillohet edhe njëherë nga e para. Mirëpo në këtë rast, kushtet nuk janë tërësisht të njëjta me efektin që jep ushtrimi i së drejtës së padisë (nëpërmjet kërkesëpadisë). Kjo për faktin se në kohën e ushtrimit të ankimit është realizuar një proces gjyqësor, ai i shkallës së parë. Palët tashmë kanë një pikë referimi më konkrete ndaj së cilës mund të drejtojnë pretendimet e tyre. Po kështu, edhe Gjykata e Apelit, ka një tërësi faktesh, mbi të cilin do të verifikojë bazueshmërinë ose jo të pretendimeve të palëve, që nuk është gjë tjetër veçse procesi gjyqësor i zhvilluar në shkallë të parë.

Në këtë pikë ka rëndësi përcaktimi i masës së procesit gjyqësor që duhet të rishikohet nga Gjykata e Apelit dhe masa e procesit gjyqësor që duhet të ribëhet prej kësaj gjykate. Masa e rishikimit të procesit gjyqësor është më e gjerë sesa masa e procesit, që duhet të ribëhet. Në përcaktimin e masës së rishikimit të procesit gjyqësor, konkurrojnë dy instrumente: (1) kërkimet e pales nëpërmjet ankimit dhe (2) e drejta e gjykatës që kryesisht të shqyrtojë edhe çështje, të cilat nuk janë ngritur si pretendime në ankim. Nga analiza e ndërthurur e LGJA dhe e K.Pr.Civile, rezulton se e drejta e gjykatës për të shqyrtuar çështje të tjera jashtë gamës së pretendimeve të ngritura në ankim përfshin fillimisht të gjitha ato çështje, për të cilat ligji shprehet se shqyrtohen apo ngrihen “kryesisht” nga gjykata. Në vijim, e drejta e gjykatës përfshin edhe çështje të tjera, siç është rasti kur Gjykata e Apelit ka të drejtë të vendosë pushimi e gjykimit, me arsyetimin se “padija nuk mund të ngrihet ose gjykimi nuk mund të vazhdonte”. Në përforcim të këtij përfundimi është edhe fakti se LGJA hesht përse i përket motiveve, në bazë të të cilave mund të ngrihet ankimi. Sa i takon të drejtës së Gjykatës së Apelit për të bërë nga e para veprime procedurale, në nenin 47 të GJA parashikohet e drejta e palëve dhe mundësia që gjykata krijon për të marrë prova të reja. Kjo mundësi është e kufizuar nga fakti i pamundësisë së palës për t’i paraqitur ato përgjatë gjykimit në shkallë të parë. Në plotësim të kësaj të drejte është edhe parashikimi i nenit 51, pika 1 shkronja “a”, sipas të cilit gjykata vendos kalimin e procedurës nga “dhomë këshillimi” në “seancë gjyqësore” kur për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të LGJA. Këto parashikime janë të tilla që dëshmojnë në analizë të fundit konkluzionin se Gjykata e Apelit ka të drejtë të kontrollojë procesin gjyqësor të shkallës së parë në të gjithë perimetrin e tij. Ky është efekti thelbësor i ankimit ndaj procesit gjyqësor të ardhshëm (gjykimit në apel). Një qasje e tillë shkon në koherencë edhe me vetë pozicionin që i është dhënë gjykatës në procesin gjyqësor administrativ. Në ndryshim nga procesi gjyqësor civil, në procesin gjyqësor administrativ gjykatës i është dhënë një rol aktiv më energjik; gjykata ka kompetencë deri edhe të zëvendësojë vetë organin administrativ në shyrtingun e veprimeve administrative.

1.4 Afatet e paraqitjes së ankimit

Afati i paraqitjes së ankimit në LGJA nuk ka një rregullim të ndryshëm nga ai i parashikuar në K.Pr.Civile. Afati 15 ditor (për ankimin e zakonshëm) dhe ai 5 ditor (për ankimin e veçantë) janë

2. Forma e kërkesës ankimore dhe elementët e saj

Vetë procesi gjyqësor administrativ priret të jetë më së shumti proces gjyqësor mbi dokumente sesa proces gjyqësor gojor. Gjithsesi, kërkesa ankimore në çdo rast përpilohet dhe paraqitet në formë të shkruar. Nga analiza e nenit 46 të LGJA, identifikohen disa elemente të kërkesës ankimore. Kështu, përveç faktit se kërkesa ankimore duhet të jetë e shkruar, ajo duhet të depozitohet në aq kopje sa janë personat që marrin pjesë në gjykim. Në ndryshim me K.Pr.Civile, numri i kopjeve të ankimit kërkohet për numër të personave dhe jo për aq sa janë numri i palëve ndërgjyqëse. Kjo do të thotë se nëse një palë ndërgjyqëse përbëhet nga më shumë se një person, kërkohet që secili prej tyre të pajiset me kopje të kërkesës ankimore. Po kështu, kërkesa ankimore duhet të bashkëshoqërohet sipas rastit edhe nga akti i përfaqësimit. Dispozita në fjalë pohon se ankimit mund t'i bashkëngjiten edhe dokumente të tjera, por që nuk specifikohen se çfarë mund të jenë. Ky parashikim ka lidhje me një mundësi procedurale që trajtohet në pjesën e gjykimit në apel lidhur me mundësinë e paraqitjes së provave të reja, të cilat pala përkatëse nuk ka mundur jo për faj të saj t'i paraqesë në gjykimin në shkallë të parë. Bëhet fjalë kryesisht jo në vetvete me provat e reja që kërkon të paraqesë në apel sipas nenit 47, por për dokumente me anë të të cilave duhet të provojë (në këtë fazë ai thjesht duhet të pohojë) faktin e pamundësisë për t'i paraqitur në gjykim dhe së dyti, faktin e mospasjes faj nga ana e tij për mosparaqitjen e tyre. Sigurisht që duhet të bashkëngjisë edhe vetë këto prova (nëse janë të dokumentuara që në atë çast). Duhet theksuar edhe njëherë roli i gjyqtarit të vetëm në këtë fazë: ai nuk ka të drejtë të bëjë shqyrtim në themel lidhur me mundësinë apo pamundësinë e paraqitjes së këtyre provave, apo me pasjen e fajit ose jo nga pala kërkuese. Ajo çfarë gjyqtari duhet të sigurojë është që të gjitha pohimet që bën pala në ankim lidhur me pasjen e dokumenteve (provave) rreth pamundësisë apo mospasjes se fajit (ashtu dhe në atë masë sa i pretendon ankuesi) duhet t'ia bashkëlidhë ankimit. Shqyrtimi në themel nëse ekziston ose jo faji apo pamundësia dhe në ç'masë provohet janë në vlerësimin ekskluziv të Gjykatës së Apelit.

Përpos këtyre elementeve, kërkesa ankimore në tekstin e saj, duhet të përmbajë: (1) nënshkrimin e kërkesës nga ankuesi ose përfaqësuesi i tij; (2) tregimin e palëve ndërgjyqëse; (3) tregimin e vendimit kundër të cilit bëhet ankim; (4) tregimin e asaj çfarë kërkohet me ankimin. Këto elemente të përmbajtjes së kërkesës ankimore janë lehtësisht të kuptueshëm e që rrallë ndodh të ngrenë dyshime. E vetmja pikë që kërkon sqarim është "tregimi i asaj çfarë kërkohet me ankimin". Ky element kërkon që pala ankuese të saktësojë qartësisht pretendimin e saj mbi formulimin dhe përmbajtjen e dispozitivit të vendimit të shkallës së parë. Siç u shpjegua më lart, Gjykata e Apelit është e lirë të kontrollojë procesin gjyqësor të shkallës së parë dhe bashkë me të edhe aktin e fundëm të procesit që është vendimi gjyqësor, porse lidhur me dispozitivin e vendimit duhet saktësuar se gjykata është e detyruar të respektojë edhe kufijtë e pretendimit të ankuesit. Ky është një trajtim i cili i bindet parimit të disponimit të padisë, sipas të cilit gjykata shprehet për aq sa kërkon pala, lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes.

Një strukturim i tillë i kërkesës ankimore me këto elemente formale është në harmoni edhe me trajtimin në themel që i bëhet ankimit si një e drejtë, teksa ushtrimi i kësaj të drejte nuk kushtëzohet nga parashkrimi i shprehur i motiveve apo arsyeve. Është për arsye të interesit të brendshëm të palës ankuese, që kjo e fundit parashtron më shumë apo më pak në

mënyrë të hollësishme arsyet për të cilat ajo ngre pretendimet e veta ndaj vendimit përkatës që apelohet. Nga pikëpamja strukturore, një kërkesë ankimore mund të hartohet në tre pjesë: (1) pjesa hyrëse; (2) pjesa arsyetuese dhe (3) pjesa përmbyllëse.

Në *pjesën hyrëse* përcaktohen ankuesi, duke treguar cilësinë e tij në gjykim dhe gjeneralitetet e tij), objekti i ankimit (vendimi që ankimohet, çfarë kërkohet me ankimin) dhe palët e tjera ndërgjyqëse.

Pjesa arsyetuese mund të ndahet në tre nënpjesë: (1) hyrja, e cila tregon në mënyrë sintetike se çfarë është vendosur me vendimin gjyqësor që ankimohet; (2) pjesa shpjeguese, ku jepet parashtrimi i qartë i pretendimeve kundër vendimit gjyqësor. Rekomandohet që pretendimet të ndahen në pretendime për procedurën e zbatuar në gjykimin në shkallë të parë dhe arsyet pse shkelja e pretenduar ka ndikuar në dhënien e vendimit dhe pretendime për themelin e vendimit, të cilat nënkategorizohen në pretendime për zbatimin e ligjit material dhe në pretendime mbi saktësinë e fakteve të pranuar nga gjykimi në shkallë të parë. Në parashtrimin e pretendimeve, sugjerohet që ato të listohen të numëtuara, duke ndjekur rendin kronologjik. Në parashtrimin e pretendimeve, nëse ato lidhen me çështje fakti, tregohen edhe provat mbështetëse të tyre, duke analizuar fuqinë provuese të tyre. Nëse pretendimet lidhen me çështje ligjore, sugjerohet që ato të shoqërohen edhe me pjesën përkatëse të jurisprudencës të gjykatave më të larta. Gjithashtu, në këtë pjesë, nëse është rasti, tregohen provat e reja që duhet të merren nga Gjykata e Apelit dhe shkaqet e sakta, për të cilat këto prova nuk janë kërkuar apo nuk janë marrë në gjykimin në shkallë të parë (dokumente, dëshmi, ekspertim, CD etj.).

Në *pjesën përmbyllëse* të ankimit parashtrihen saktë kërkimet, për të cilat kërkohet të shprehet Gjykata e Apelit, në përputhje me objektin e ankimit. Në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali jepet një model i kërkesës ankimore.

3. Vendi i paraqitjes së ankimit

Kërkesa ankimore paraqitet në gjykatën, ku është dhënë vendimi gjyqësor që ankimohet. Me paraqitjen e tij fillon procedura e shqyrtimit të ankimit në shkallë të parë, që verifikon pararakisht elementet formale të kërkesës ankimore, duke synuar zhdërvjelltësimin e gjykimit në apel. Kjo procedurë zhvillohet nga gjykata e shkallës së parë për shkak se kjo gjykatë është më afër procesit gjyqësor dhe ka lehtësinë për të shqyrtuar objektivisht elementet formale të kërkesës ankimore. Në këtë lloj procedure, gjykata e shkallës së parë shqyrton përmbushjen ose jo të kërkesave formale të kërkesës ankimore dhe jo “bazueshmërinë” apo “motivimin” e saj. Kontrolli i këtij drejtimi të dytë është lëndë ekskluzive shqyrtimi e Gjykatës së Apelit. Përsa i përket procedurës që ndjek gjyka e shkallës së parë, duhet theksuar se ky lloj gjykimi ka më shumë natyrë konsultuese/asistuese sesa vendimarrëse. Qëllimi i saj është të lehtësojë plotësimin e aspektit të dokumenteve të ankimit dhe pjekurisë së dosjes në këndvështrimin procedural në mënyrë që çështja të jetë e gatshme për t’u shqyrtuar në Gjykatën e Apelit. Qëllimi i kësaj procedure nuk është vendosja e një filtri pengues ndaj paraqitjes së ankimit. Kjo është arsyeja, që gjykata kur gjen mangësi formale të kërkesës ankimore apo të dokumenteve shoqëruese, si p.sh. kopje të numrit të ankimeve në numër aq sa janë personat që marrin pjesë në gjykim, akti i përfaqësimit, nuk është nënshkruar, nuk tregohen palët ndërgjyqëse, apo vendimi kundër të cilit bëhet ankim ose se çfarë kërkohet me ankimin, gjyqtari i vetëm njofton palën që të ndreqë të metat brenda 5 ditëve. Ky proces zhvillohet në dhomë këshillimi nga gjyqtari i vetëm, i cili tekta i lë një afat gjer në 5 ditë palës ankimore, identifikon edhe të metat që duhet të plotëson nga ankuesi. Afati 5 ditor është i përcaktuar nga ligji dhe nuk mund të zgjatet nga gjykata. Në këtë rast, gjyqtari i vetëm nxjerr *vendimin për ndreqjen e të metave të ankimit* sipas parashikimit të nenit 46,

pika 2, i cili është vendim i ndërmjetëm. Në dispozitivin e këtij vendimi, gjyqtari urdhëron njoftimin e tij ankuesit. As LGJA dhe as K.Pr.Civile nuk japin një parashikim mbi formën apo elementet e tjera të përmbajtjes të këtij vendimi të ndërmjetëm. Meqë ky akt është një vendim i ndërmjetëm, atëherë ai trupëzohet në procesverbalin e seancës në dhomë këshillimi, por për shkak se i njoftohet palëve dhe ankimohet. veçmas, hartohet edhe në një akt autonom. Elementet e tjera formale të këtij lloji vendimi të ndërmjetëm huazohen dhe përdoren *mutatis mutandis* nga elementet e vendimit përfundimtar. Një model i dispozitivit të vendimit gjyqësor të kësaj natyre jepet në Shtojcën e këtij Manuali.

Procedura e verifikimit të plotësisimit apo ndreqjes së të metave të kërkesës ankimore ka dy alternativa të mundshme përfundimi. Në alternativën e parë, ankuesi brenda afatit të caktuar gjer në 5 ditë, plotëson të metat që i ka njoftuar gjyqtari i vetëm. Në këtë rast, dokumentet e sjella rishtas apo edhe kërkesa ankimore e riplotësuar, i bashkëngjiten kërkesës ankimore fillestare fizikisht dhe po kështu i përcillen sekretarisë gjyqësore për të kryer veprimet e tjera (përcjellja e ankimit me dokumentacionin tjetër në gjykatën e apelit). LGJA nuk kërkon në këtë rast ndonjë akt formal procedural; procesverbal apo vendim. Në rastin kur të metat e kërkesës ankimore plotësohen rregullisht dhe në afat nga pala, ankimi konsiderohet se është ushtruar që prej dates së paraqitjes së kërkesës ankimore fillestare edhe pse rezultoi me mangësi. Alternativa e dytë është kur të metat e ankimit nuk plotësohen dhe në këtë rast, gjyqtari i vetëm merr një vendim tjetër jopërfundimtar; vendimin për kthimin e ankimit. Këtij vendimi i bashkëngjiten fizikisht kërkesa ankimore dhe të gjitha dokumentet përkatëse të paraqitura nga ankuesi. Mospërmbushja e të metave në afatin e caktuar, passjell efektin që ankimi konsiderohet se nuk është paraqitur. Efekti “konsiderohet se nuk është paraqitur” është vetëm juridik, sepse në praktikë një procedurë e tillë dokumentohet rregullisht në burimet arkivore në gjykatë, ku ruhet edhe një kopje e një vendimit gjyqësor të dhënë. Elementet formale të këtij lloji vendimi të ndërmjetëm huazohen dhe përdoren *mutatis mutandis* nga elementët e vendimit përfundimtar. Një model i dispozitivit të vendimit gjyqësor të kësaj natyre jepet në Shtojcën e këtij Manuali. Ndaj një vendimi të tillë mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit. Së fundi, për këtë çështje duhet saktësuar se regjimi juridik i procesit gjyqësor të shqyrtimit të përmbushjes së kërkesave formale të ankimit vlen vetëm për ankimin e zakonshëm dhe jo për ankimin e veçantë. Ky i fundit depozitohet në gjykatën e shkallës së parë dhe përcillet drejtpërdrejt në Gjykatën e Apelit, së bashku me dokumentacionin tjetër, pa ushtruar një filtër procedural pranë gjykatës së shkallës së parë. Duket që në këtë rast nevoja për shpejtësi ka epërsi, sepse rastet e ankimit të veçantë karakterizohen nga urgjenca, të cilat i japin shkak edhe afatit shumë të shkurtër 5 ditor të ankimit të veçantë. Nga ana tjetër, një proces i tillë filtrimi paraprak, i ankimueshëm në mënyrë të veçantë në procedurën e paraqitjes së ankimeve të veçanta do të krijonte një zinxhir të turbullt ankimesh të veçanta.

3.1 Kundërankimi në Gjykatën e Apelit

Kundërankimi në Gjykatën e Apelit, në ndryshim nga kundërrekursi, nuk rregullohet në mënyrë të posaçme nga LGJA, ndonëse ekzistenca e tij pranohet nga neni 49, pika 2 nuk parashikon në mënyrë të shprehur kundërankimin, sipas të cilit, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim. Në këtë situatë, vepron sërish neni 1, pika 2 dhe neni 44 i LGJA, në zbatim të të cilave rregullat e zbatueshme për kundërankimin në Gjykatën e Apelit gjenden në nenin 456 të K.Pr.Civile. Kjo dispozitë, e emërtuar “Ankimi kundërshtues”, parashikon se “Pala që nuk ka bërë ankim apo pala kundër së cilës është bërë ankimi, mund ta kundërshtojë atë me kundërankim brenda 5 ditëve nga dita që ka

marrë njoftim për ankimin e palës tjetër. Ankimi kundërshtues duhet t'u njoftohet palëve të tjera në gjykim, sipas rregullave për njoftimin e ankimit". Prej këtij parashikimi deduktohet konkluzioni se ankimi kundërshtues në Gjykatën e Apelit, i njohur edhe si kundërankim apo si apel kundërshtues, ka të njëjtin regjim juridik me apelin. Për pasojë, të gjitha udhëzimet për ankimin dhe aktet që i bashkëlidhen atij janë të vlefshme edhe për kundërankimin. Kundërankimi mund të cilësohet si akti i fundit procedural që i bashkangjitet dosjes gjyqësore, pasi është shqyrtuar në elementet e tij formale nga gjyqtari i vetëm në shkallë të parë. Një çështje që kërkon vëmendje është situata e plotësimit të kërkesave formale të kundërankimit në afate të shkurtra kohore, procedurë e cila kryhet nga gjyqtari i vetëm në shkallë të parë. Në kushtet kur apeli kundërshtues është i lidhur me apelin, afatet e veprimeve procedurale të gjyqtarit të vetëm marrin karakter përsheptues. Neni 48 pika 1 të LGJA, urdhëron që dosja gjyqësore së bashku me aktet e ankimit duhet të përcillet në Gjykatën e Apelit, brenda 15 ditëve nga paraqitja e ankimit. Kjo nënkupton, që në rastin e paraqitjes së kundërankimit, gjyqtari brenda 15 ditëve, duhet të shqyrtojë të metat e ankimit, t'i japë afat gjer në 5 ditë ankuesit për plotësimin e të metave të mundshme, të shqyrtojë të metat e kundërankimit dhe t'i japë afat edhe kundërankuesit për plotësimin e të metave të mundshme. Rrjedhimisht, gjyqtari i vetëm duhet të veprojë sa më shpejt, të përdorë efektivisht kohën dhe të urdhërojë njoftime të menjëhershme të ankimit.

3.2 Ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit

Ankimi i veçantë, në thelb, është një instrument procedural me natyrë të jashtëzakonshme në raport me konceptin e procesit gjyqësor administrativ si një seri hapash të njëpasnjëshme procedurale të renditura kronologjikisht dhe që shërbejnë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë pikëpamje, e drejta kushtetuese e ankimit e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës dhe e përpunuar në legjislacionin procedural synon të garantojë një kontroll efektiv të procesit gjyqësor nga një shkallë më e lartë gjykimi. Duke iu referuar këtij koncepti duket sikur ankimi i veçantë është i padobishëm sepse 'djeg' para kohe etapat e shqyrtimit në një shkallë më të lartë të disa çështjeve procedurale. Mirëpo, qëllimi i ekzistencës së ankimit të veçantë është krijimi i një ekuilibri të përshtatshëm për individin në një proces gjyqësor në drejtim të urgjencës, të ekonomisë gjyqësore dhe të sigurisë juridike. Çështjet, për të cilat ligji lejon ankim të veçantë janë të përcaktuara shprehimisht dhe mbulojnë situata urgjente (juridiksioni, sigurimi i padisë etj), zgjidhja e të cilave jo vetëm dikton zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes, por mundësia e gjykatës për të gabuar në këto raste duhet verifikuar aty për aty, për të shmangur dëmin nga vonesa gjer në përfundimin e çështjes. Nga ana tjetër, vendosja e ankimit të veçantë për një grup të përcaktuar çështjesh procedurale, ekonomizon edhe procesin gjyqësor sepse thjeshton procesin gjyqësor në shkallët më të larta. Kjo sepse çështjet procedurale, për të cilat lejohet ankim i veçantë, nuk janë pjesë e ankimit të zakonshëm dhe rrjedhimisht, nuk janë pjesë e procesit gjyqësor që bazohet në ankimin e zakonshëm. Së fundi, ankimi i veçantë i shërben edhe sigurisë juridike të palëve ndërgjyqëse, sepse verifikimi aty për aty i tyre nga gjykata më e lartë, iu heq palëve gjendjen e pasigurisë, që mund t'i mbajë ato përgjatë gjithë procesit. Në procesin e paraqitjes dhe të shqyrtimit të ankimit të veçantë ka një kufi të brishtë të zgjidhjes së çështjes procedurale urgjente me zgjidhjen e fakteve që lidhen me themelin e mosmarrëveshjes, i cili nëse shkelet rrezikon paragjykimin e vendimarrjes përfundimtare në shkallë të parë. Teorikisht, duhet që pjesë e ankimit të veçantë dhe e procesit të shqyrtimit të tij në Gjykatën e Apelit të jetë vetëm një segment procedural, por në praktikë ndodh që ky proces vështirësohet pasi merren në analizë edhe fakte të mbledhura dhe veprime procedurale të kryera në shkallë të parë, që i kanë

paraprirë çështjes procedurale, që i nënshtrohet ankimit të veçantë. Rastet, që i nënshtrohen ankimit të veçantë, të përcaktuara shprehimisht në LGJA, janë vendimi për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor dhe për dërgimin e akteve organit kompetent, vendimi për kthimin e padisë dhe të akteve, që i bashkëlidhen asaj, vendimi për pranimin apo refuzimin e kërkesës për sigurimin e padisë, si dhe vendimet për ndryshimin e tij, vendimi për kthimin e apelit kur të metat nuk janë plotësuar apo ndrequr brenda afatit, vendimi për kthimin e rekursit kur të metat nuk janë plotësuar apo ndrequr brenda afatit. Këtu duhet pasur kujdes sepse këto raste plotësohen edhe me ato të përcaktuara nga K.Pr.Civile, nëse vetë LGJA nuk parashikon ndryshe. Një veçori procedurale e ankimit të veçantë në raport me ankimin e veçantë lidhet me mungesën e filtrimit paraprak të tij prej gjyqtarit të vetëm në shkallë të parë. Ankimi i veçantë vërtet depozitohet në gjykatën e shkallës së parë, por ai nuk i nënshtrohet procedurës së shqyrtimit paraprak të elementëve formalë. Ankimi i veçantë i përcillet Gjykatës së Apelit dhe i takon kësaj gjykate të shqyrtojë elementet formaleë, si dhe thelbin e vetë ankimit të veçantë. Arsyet e këtij rregullimi të ndryshëm procedural lidhet me urgjencën që ka çështja, për të cilën ushtrohet ankimi i veçantë, si dhe me ekonomizimin e procesit gjyqësor, për të shmangur zinxhirin e ankimeve të veçanta njëri pas tjetrit Elementeve formale të ankimit të veçantë dhe dokumenteve që i bashkëngjiten atij, nuk iu kushtohet ndonjë rregullim i veçantë në LGJA. Rrjedhimisht, rregullat e vlefshme për ankimin e zakonshëm janë të zbatueshme edhe për ankimin e veçantë në këtë drejtim.